



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 98, Datë 09.05.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “H&K@VALA MAR RESIDENCES” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 608/2 prot., datë 28.04.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@VALA MAR RESIDENCES” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 570 prot., datë 15.04.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal,

si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike - Neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “c”, “d”, “f” dhe “h”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike - Neni 9, pika 4.7

- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).
Shoqëria nuk ka depozitur dokumentacion mbështetës ku të vërtetohet që e disponon të gjithë shumën që ka deklaruar për mbështetjen e veprimtarisë.
- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).
Shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen për sistemin IT për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se ka bërë me dije se ka filluar punën për siguruar mbështetjen me infrasktrukturën e nevojshme të një sistemi të integruar të proceseve kryesore të biznesit aktual, ose marrëveshje me tregtarë aktivë në treg për të siguruar (“outsource”) shërbimet e skedulimit dhe të tjera që lidhen me veprimtarinë e furnizimit, derisa shoqëria të krijojë kapacitetet e veta.
- **gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria duhet të bëjë saktësimin e disponimit të këtyre zyrave dhe kohën kur do t’i disponojë ato, referuar faktit që ka bërë me dije se objekti është në ndërtim.
- **gërma “i”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). Shoqëria duhet të bëjë me dije dhe nivelin e tensionit të parashikuar për furnizimin e klientëve.
- Për sa bërë me dije nga shoqëria që do të sigurojë energjinë elektrike për rishitje tek mjediset e vetë shoqërisë dhe klientët e rezidencës, do t’i kërkohet shoqërisë të saktësojë klientet që parashikon të furnizojë, pasi aktualisht detyrimin e shërbimit publik për klientët familjarë e ka Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI